



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Kosova Cumhuriyeti



Komuna e Prizrenit
Opština Prizren
Prizren Belediyesi

**Procesverbali i dëgjimit publik për Buxhetin e
Komunës së Prizrenit për vitin 2027 i organizuar nga
Kuvendi Komunal**

Bazuar në Ligjin Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, Ligjin Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, Statutin e Komunës së Prizrenit Nr. 01/011-5643, të datës 15.10.2008, Udhëzimin Administrativ (MAPL) Nr. 04/2023 për Administratë të Hapur në Komuna, si dhe Rregulloren Nr. 01/2025 për Transparencë në Komunën e Prizrenit, si dhe me qëllim të sigurimit të pjesëmarrjes aktive të qytetarëve në proceset vendimmarrëse, Kuvendi Komunal i Prizrenit organizoi dëgjim publik me gjithë qytetarët e Komunës së Prizrenit për shqyrtimin dhe diskutimin e Buxhetit të Komunës për vitin 2027 dhe planifikimeve buxhetore për vitet 2028/2029.

Qëllimi i këtij dëgjimi publik ishte informimi i qytetarëve dhe palëve të interesit lidhur me orientimet dhe prioritetet kryesore buxhetore të Komunës, si dhe mbledhja e propozimeve, sugjerimeve dhe vërejtjeve të tyre, me synim që procesi i planifikimit të buxhetit të jetë sa më transparent, efikas, gjithëpërfshirës dhe në përputhje me nevojat dhe prioritetet e komunitetit.

Gjatë dëgjimit publik, qytetarët patën mundësi të shprehin kërkesat dhe shqetësimet e tyre, si dhe të paraqesin propozime konkrete për investime dhe përmirësimin e shërbimeve publike. Diskutimet u fokusuan në identifikimin e prioritetëve zhvillimore në fusha të ndryshme, përfshirë infrastrukturën, arsimin, shëndetësinë, shërbimet publike, zhvillimin ekonomik lokal dhe fusha të tjera me interes për qytetarët e Komunës së Prizrenit.

Ky procesverbal hartohet me qëllim të dokumentimit të rrjedhës së dëgjimit publik, evidentimit të pjesëmarrjes së qytetarëve dhe palëve të interesit, si dhe pasqyrimin të kontributit të tyre përmes propozimeve, sugjerimeve dhe vërejtjeve të paraqitura gjatë takimit.

Njëkohësisht, procesverbali shërben si dokument zyrtar për transparencën institucionale dhe llogaridhënien publike, ndërsa kontributet e paraqitura do të merren në konsideratë gjatë procesit të shqyrtimit dhe finalizimit të Buxhetit të Komunës së Prizrenit për vitin 2027 dhe planifikimeve për vitet 2028/2029.

Publikimet:

Publikimet janë bërë me **02:09.2026** në webfaqe zyrtare të komunës, në facebook-un e komunës:

Në webfaqe:

<https://prizren.rks-gov.net/wp-content/uploads/2026/09/Njoftim-per-organizimin-e-degjimit-publik-per-Buxhetin-e-Komunes-se-Prizrenit-per-vitin-2027-Shq-Tur-Bosh.pdf>

Njoftimi si lajm në webfaqe:

<https://prizren.rks-gov.net/news/njoftim-per-organizimin-e-degjimit-publik-per-buxhetin-e-komunes-se-prizrenit-per-vitin-2027/>

Facebook:

<https://www.facebook.com/share/p/19GaJ2hhJH/>

Memorandumi shpjegues:

<https://prizren.rks-gov.net/wp-content/uploads/2026/09/Memorandum-shpjegues-per-degjimin-publik-per-buxhetin-e-vitit-2027-i-organizuar-nga-Kuvendi-Komunal.pdf>

Dëgjimi është mbajtur në sallën e mbledhjeve të Kuvendit Komunal të Prizrenit dhe ka filluar në orën **10:13**.

Hapja e dëgjimit e dëgjimit publik është bërë nga Haziz Krasniqi, zyrtar i larë për Informim dhe Raportim duke thënë se jemi sot në këtë dëgjim publik buxhetor për Projekt-buxhetin e Komunës së Prizrenit për vitin 2027, i organizuar nga anëtarët e Kuvendit të Komunës së Prizrenit. Ky dëgjim zhvillohet pas pranimit dhe dorëzimit të propozim-buxhetit nga Kryetari i Komunës së Prizrenit, Shaqir Totaj.

Organizimi i këtij dëgjimi publik bëhet me qëllim të rritjes së transparencës, informimit të qytetarëve dhe përfshirjes së tyre në procesin e planifikimit dhe miratimit të buxhetit komunal. Dëgjimi i sotëm është i karëti me radhë dhe i fundit për këtë vit.

Rrjedha e dëgjimit publik do të jetë si në vijim:

Fjalë rasti nga Kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Prizrenit, Simir Krasniqi;

Prezantimi i Projektbuxhetit nga zyrtarët e Drejtorisë së Financave;

Diskutimi dhe parashtrimi i pyetjeve, kërkesave dhe propozimeve nga qytetarët dhe të pranishmit.

Për mbajtjen e këtij dëgjimi publik do të mbahet procesverbal dhe do të hartohet raport me të gjitha detajet, dhe përgjigje do tju jepet të gjitha kërkesave të cilët bëhen nga ana juaj.

Fjalë rasti nga Kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Prizrenit, Simir Krasniqi i cili ka thënë se pas pranimit të Projekt - Buxhetit nga Kryetari Komunës zot.Shaqir Totaj për vitin 2027 dhe planifikimet për vitet 2028-2029.

Para miratimit në Kuvend nga antarët e Kuvendit në aspektin ligjor detyrohem që unë si Kryesues i Kuvendit të organizoj degjimin publik buxhetor me Kuvedarë për Projekt - Buxhetin e Komunës për vitin 2027 planifikimet për vitet 2028 - 2029

Pas shumë degjimeve publike me Komunitetin, Kryetarë të Bashkësive lokale, OJQ, Biznese. Ku janë degjuar dhe marrë të gjitha kërkesat dhe nevojat e tyre për përfshirjen e projekteve të tyre ne Projekt-Buxhetin e vitin 2027 ku është bërë më mira e mundëshme duke pasur një Buxhet gjithëpërfshirës.

Ju e dini edhe vështërsitë e Komunës me permbaruesin ku Komunës së Prizrenit vetëm për vitin 2026 janë marrë 20 mil.Euro nga Kontrata Kolektive në arsim që kjo pagesë është dashur te kryet nga Ministria e Arsimit dhe jo ti merren mjetet nga projektet kapitale të Komunës.

Por si do që të jetë falenderojë Kryetarin, Drejtorët, ZKF që kanë bërë më të mirën e mundëshme që ta finalizojnë Projekt - Buxhetin për vitin 2027 dhe planifikimet për vitet 2028-2029. Ky buxhet të jetë gjithëpërfshirës.

Për më tepër i kemi edhe Drejtorët dhe ZKF ketu për qdo pyetje te juajen mund të ju përgjigjen.

Prezantimi i Projekt-buxhetit për vitin 2027 u bë nga zyrtarët e Drejtorisë së Financave, ndërsa para të pranishmëve Projekt-buxhetin e prezantoi Zyrtari Kryesor Financiar, Lulzim Sylejmani. Ai bëri të ditur se buxheti i Komunës së Prizrenit për vitin 2027 parashihet të jetë në vlerë prej 79,118,940.00 €, duke paraqitur në mënyrë të detajuar strukturën dhe ndarjen e mjeteve buxhetore sipas kategorive kryesore të shpenzimeve.

Sipas prezantimit, 32,588,843.00 € janë planifikuar për kategorinë Paga dhe mëditje, 15,730,224.00 € për Mallra dhe shërbime, ndërsa për Shpenzime komunale janë paraparë 1,405,299.00 €. Për kategorinë Subvencione dhe transfere janë planifikuar 5,713,459.00 €, ndërsa 23,681,115.00 € janë ndarë për Shpenzime kapitale, të cilat përfshijnë investimet dhe projektet kapitale të Komunës.

Gjatë prezantimit u theksua rëndësia e procesit të dëgjimeve publike buxhetore, përmes të cilave qytetarët, përfaqësuesit e institucioneve, organizatat dhe grupet e interesit kanë pasur mundësinë të paraqesin kërkesat dhe propozimet e tyre.

Kërkesat e qytetarëve:

Faik Berisha-kryetar i këshillit të fshatit Landovicë

- 1-Rregullimi i 1 kilometer rruge nga market Laja e mahalla e Gashve e cila do te lidhet me Hasin;
- 2-Hapja e rrugeve fushore;
- 3-Pastrami i shtratit te lumit ne fshatin Landovic.

Almir Bajrami-kryetar i këshillit të fshatrave Mushnikovë, Sreckë, Gornje Sello, Prevallë

- 1-Ndertimi i shtepis se cultures ne fshatim Mushnikove;
- 2-Ndarja e tensionit te larte nga fshati Gornjosell me Prevallen.

Kreshnik Qollaku-banor i fshatit Bregdri

- 1-Rregullimi dhe intervenimi ne objektin e shkollës;
- 2-Ndertimi i trotuarit;
- 3-Ndertimi i fushës sportive;
- 4-Mungesa e rrymës .

Bujar Pulaj, kryetar i këshillit të fshatrave Vërmicë, Shkozë, Dobrusht

- 1-Rehabilitimi i rrjetit te ujësjellësit dhe vendosja e ujëmatësve ne Vermic, Shkoz dhe Dobrusht;
- 2-Ndriwimi publik ne Vermic;
- 3-Rregullimi i kanalizimit ne shkollën e fshatit Shkozë;
- 4-Ndertimi i një rezervari për ujin e pijshëm ne Dobrusht.

Erion Markaj, banor i lagjes Anton Qeta në Prizren

- 1-Rregullimi i rrugëve Pal Paluca, Anton Qeta dhe tjerave për rreth;
- 2-Regullimi dhe vendosja e ndriçimit publik;
- 3-Parkimet jo të rregullta të cilat po e bllokojnë hyrjen në rrugica.

Simon Veseli, kryetar i këshillit të fshatrave Velezhë, Sërbicë e Epërme, Trepetnicë, Shpenadi dhe Smaç

- 1-Pastrimi i shtratit të lumit nga Shepnadija, Velezh dhe Caparc;
- 2-Ndriçimi publik në të gjitha këto fshatra;
- 3-Meremetimi i rrugëve të dëmtuara nga KEDS-i;
- 4-Hapja e rrugëve fushore në të gjitha këto fshatra;
- 5-Shtrimi i rrugëve me kabëza në gjatësi prej 1000-1200 metra;
- 6-Vendosja e kanalizimit në gjatësi 1000-1200 metra .

Marte Prekpalaj kryetare e këshillit të fshatrave Zym, Karashëngjergj, Krajk dhe Bregdri

- 1-Ndertimin e trotuarit;
- 2-Ndertimin e kanalizimit;
- 3-Ndertimin e oborrit të shkollës;
- 4-Ndertimin e rrugëve;
- 5-Siguria në fshatrat e Hasit;
- 6-Shendetësia të jetë në nivel për këto fshatra.

Resmije Rahmani

- 1-Në të gjitha kërkesat dhe ndërtimet të cilat behën të parashihen edhe kërkesat për persona me aftësi të kufizuara;
- 2-Rregullimi i rrugës Beteja e Kabashit dhe të mundësohet qasja për personat me aftësi të kufizuara.

Petrit Hoxhaj, kryetar i këshillit të fshatrave

- 1- Vendosja/rregullimi i ujit të pijshëm në fshatin Vlashnje .

Besmir Shala, kryetar i këshillit të fshatit Billushë

- 1-Vendosja e ujit të pijshëm në të gjithë fshatin pasi që po kemi vetëm 10 min ujë në ditë.

Osman Osmanaj-OJQ Novo Concept

- 1-Të ndahet buxheti për realizimin e planeve të veprimit për komunitete.

Fatmir Menekshe-OJQ DrumishAsllano

- 1-Të ndahet buxhet më shumë për projektin e ndërtimit të shtëpisë së kulturës për komunitetin Romë, Ashkali dhe Egjiptian;
- 2- Ndryshimi i rrjetit të kanalizimit në rrugën Nysret Searsoj .

Resmije Krasniqi shoqata Hader

- 1-Ndertimi i rrugës vetëm për shoqatën Hader dhe ndarja nga rruga e ambulantes;
- 2-Dhenja e një lokali ne lokacionin e Shatërvanit për shfrytëzimin e reklamimit te punëve te dorës qe kryhen nga kjo shoqatë.

Ramë Himaj, kryetar i këshillit të fshatrave Romaj dhe Lukinjë

- 1- Nderimi i murit te varrezat dhe largimi i uzurpatorëve nga vendi i varrezave;
- 2-Rregullimi i sistemit të ujit të pijes;
- 3-Rregullimi i proçkës;
- 4-Rregullimi i ndriçimit publik;
- 5-Pastrimi i kanalizimit në lagjen Selmanaj.

Ilami Axhillari, Kryetari i Këshillit Lokal “10 Qershori” në Prizren

1- Kërkesë 1(lagjja “Bylbyldere”)

Rregullimi i infrastrukturës nëntokësore, kanalizimi për ujërat atmosferik – fekale, si dhe ndërrimi i gypit të asbestit i cili furnizon banorët me ujë të pijes, (të gjithë bashkë me gjatësi rreth 600 m), në rrugët

1. "Xhavit Bajraktari"
2. "Anif Muji"

2- Kërkesë (lagjja nënkalaja):

Rregullimi i rrugëve, trotuarëve, infrastrukturës nëntokësore, ndërtimi i pushimoreve dhe vendosja e disa ulëseve (të gjitha bashkë me gjatësi rreth 700 m): në rrugët

1. "Pal Paluca"
2. "Mentor Krasniqi"
3. "Anton Çetta"
4. "Lazër Lumezi"
5. "Shën Albani"

Është me rëndësi që në disa vende të këtyre rrugëve të vendosen mbështetëset anësore për këmbësorë për shkak të pjerrtësisë të madhe të terrenit dhe rrezikut të lëvizjes së njerëzve të moshuar.

3- Kërkesë (lagjja bylbyldere)

Rregullimi i i tri rrugëve me kubza betoni, (të gjitha bashkë me gjatësi rreth 500 m), në rrugët:

- "Anif Muji"
- "Martirët e Struzhës"

4- Kërkesë (lagjja Bylbyldere)

Rregullimi i kanalit (prockë) për rrjedhjen e ujërave atmosferike me gjatësi 250 m, në Rrugën “Anif Muji”

Dëgjimi ka përfunduar në orën 11:15.

Për të siguruar transparencë dhe informim të plotë të publikut, Projekt Buxheti u është shpërndarë në formë fizike të gjithë pjesëmarrësve në dëgjim. Njëkohësisht, këto dokumente janë publikuar në faqen zyrtare dhe kanë qenë të qasshme për të gjithë qytetarët përmes vegëzave përkatëse:

Ueb faqen zyrtare në rubrikën dëgjim publik dhe financat: <https://prizren.rks-gov.net/degjimet-buxhetore/?tax=> , <https://prizren.rks-gov.net/financa/> dhe <https://prizren.rks-gov.net/qarkorja-buxhetore/> : <https://prizren.rks-gov.net/degjimet-buxhetore/?tax=projekt-buxheti> .

Me 10.09.2026, është mbajtur takimi publik, vegëza e publikimit të lajmit për mbajtjen e dëgjimit:

Në webfaqe:

<https://prizren.rks-gov.net/news/kuvendi-komunal-i-prizrenit-mbajti-degjim-publik-per-buxhetin-e-vitit-2026/>

Në facebook:

<https://www.facebook.com/share/p/1EqzLSobkN/>

Procesmbajtës:

Gjafer Ponik

Haziz Krasniqi